VENDIM
Nr.299, datë 22.12.2004

PËR HEQJEN E LICENCËS SË "TV DRINI"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Halil	Lalaj	Kryetar
Albert	Minga	Zëvendëskryetar
Sefedin	Çela	Anëtar
Lazër	Stani	Anëtar
Visar	Zhiti	Anëtar
Agim	Duro	Anëtar
Fatos	Lulo	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKTI: Mbi vlefshmërinë e licencës së "TV Drini".

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 33 pika 5, vendimi i KKRT-së nr.215, datë 26.2.2004 i KKRT-së "Mbi shlyerjen me këste të pagesave për licencë për vitin 2003 të disa subjekteve televizive", vendimi i KKRT-së nr.266, datë 30.9.2004 "Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve televizive private".

Subjekti fizik Sajmir Nasufi është licencuar me vendimin nr.29, datë 30.10.2000 si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për televizionin "TV Drini", me nr. licence 033/TVL.

Me vendimin nr.266 pika 1/2, datë 30.9.2004 "Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve televizive private", Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka vendosur të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv vendor "TV Drini", pasi nuk ka shlyer pagesën vjetore të licencës për vitin 2003. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjektit i është lënë një afat prej 15 ditësh, për të dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë vendim.

Nga ana e subjektit "TV Drini" nuk është paraqitur asnjë pretendim.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE I TELEVIZIONIT,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes, znj.Argita Shkupi dhe znj.Ermira Mushi, subjekti në mungesë,

VËREN:

Me vendimin nr.215 pika 1/5, datë 26.2.2004 "Mbi shlyerjen me këste të pagesave për licencë për vitin 2003 të disa subjekteve televizive", Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka miratuar shlyerjen me pesë këste të pagesës vjetore të licencës për vitin 2003, në shumën 25.8 mijë lekë, të operatorit televiziv vendor privat "TV Drini". Afati për shlyerjen e kësaj pagese, bazuar në memorandumin dypalësh të miratuar sipas pikës 2 të vendimit të mësipërm, ka qenë deri në datën 30 qershor 2004.

Ky memorandum i është dërguar subjektit "TV Drini" me shkresën nr.254, datë 27.2.2004, por nuk është nënshkruar nga ana e tij. Subjekti, me gjithë kalimin e afateve për secilin këst, të përcaktuara në memorandum, nuk ka shlyer asnjë pjesë të pagesës vjetore të licencës për vitin 2003. Në rastin e mospagimit të kësteve brenda afatit, në memorandum është parashikuar e drejta e KKRT-së për heqjen e licencës.

KKRT-ja vëren se, bazuar në nenin 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ka të drejtë ta bëjë të pavlefshme licencën kur subjekti nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj.

KKRT-ja me vendimin nr.266 pika 1/2, datë 30.9.2004, ka vendosur paraprakisht, ta bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv vendor "TV Drini".

Në mbështetje të nenit 137/3 "Për t'i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin

për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi", është njoftuar subjekti me shkresën nr.1023, datë 4.10.2004 dhe më pas, për shkak të shtyrjes së shqyrtimit të çështjes është bërë njoftim për të marrë pjesë me shkresën nr.1270/1, datë 16.12.2004.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në bazë të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, si dhe të vendimeve nr.215, datë 26.2.2004 dhe nr.266, datë 30.9.2004 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën subjektit televiziv vendor privat "TV Drini";
2. Licenca nr. 033/TVL bëhet e pavlefshme;
3. Subjekti "TV Drini" është i detyruar të ndërprese menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative";
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj